



Revyja e 7-të republikane e këngëve, muzikës dhe valleve



## Pensionistët janë mbrojtësit e pasurisë kulturore

Në Revy duartrokitjet më të fuqishme dhe më të gjata fitoi kënga "Një eshtë Zoti, një eshtë Allahu, një eshtë Maqedonia" të cilën e interpretroi maqedonasa me një zë të fuqishëm dhe të bukur, shoqëruar me tingujt e instrumenteve në të cilat luanin shqiptarët, ndërsa me të cilën u prezantua shoqata e pensionistëve nga Gostivari

Para 15 viteve, më 12 nëntor të vitit 2003, në Probištip, qytetin e minatorëve dhe pensionistëve të lumtur, eshtë mbajtur Revyja e parë e ansambleve folklorike, grupeve të këngë-

tarëve dhe instrumentalistëve, në të cilën kanë marrë pjesë nëntë shoqata e pensionistëve: Prilepi, Kumanova, Gazi Baba - Shkupi, Koçani, Kavadari, Gjevgjelia, Berova, Llozova dhe qyteti nikoqir Probištipi. Më 6 qershor të vitit 2017 në sallën e Shtëpisë së ARM në Shkup, e cila ishte e mbushur deri në vendin e fundit, u mbajt Revyja e shtatë republikane e këngëve, muzikës dhe valleve. Të jesh prezent në manifestimin më masovik kulturor të pensionistëve ishte kënaqësi e vërtetë, sepse ajo eshtë pjesa përfundimtare e revye rajonale folklorike që sivjet kanë shënuar jubileun e 15 vjetorit.

Në sallë, jo rrallë kanë kënduar edhe pjesëmarrësit e publikut. Në ritmin e muzikës kanë rrahur edhe

zemrat. Rridhni kujtime fëmijëria dhe rinia. Gërmesheshin ndjenjat e krenarisë përrënjet e tyre, krenarisë që bota na njeh pikërisht për nga bukuria dhe originaliteti i folklorit të Maqedonisë, për nga këngët dhe vallet që janë shenja shekulllore të identitetit dhe mos luhatjes për të gjitë që jetojnë në këto vende. Këngët dhe vallet shfaqin krenarinë tonë që edhe pse jemi vend i vogël, pasuri të pakrashueshme kulturore që rrallë kush mund të lavdërohet në botë.

Në Revy duartrokitjet më të fuqishme dhe më të gjata fitoi kënga "Një eshtë Zoti, një eshtë Maqedonia" të cilën e interpretroi maqedonasa me një zë të fuqishëm dhe të bukur, shoqëruar me tingujt e instrumenteve në të cilat luanin shqiptarët,

ndërsa me të cilën u prezantua shoqata e pensionistëve nga Gostivari.

Në fillim të Revysë republikane, e cila ishte e shtata me radhë, të pranishmëve në sallë ju drejtua dhe i përhëndeti kryetari i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski, i cili mes tjerash ka potencuar besimin e pjesëtarëve të gjeneratës së tretë në Maqedoninë e lumtur, prosperuese dhe të përfjetshme.

Edhe ky manifestim masovik kulturor i pensionistëve ka treguar se bartës të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë janë bashkimi, bashkëjetesa dhe shoqërimi si bazë për mbijetësë dhe për të gjitha aktivitetet e pensionistëve si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen dhe të ardhmen.

## Tubim masovik i pensionistëve në Elenec

Më 11 qershor, edhe këtë vit pas të gjashtën herë u mbajt pikniku tradicional në fshatin Cera "Elenec 2017", nën organizim të SHP Makedonska Kamenica, VL dhe bashkësisë lokale të fshatit. Shiu nuk i pengoi pensionistët nga të gjitha rajonet e Maqedonisë që të vizitojnë lokalitetin e mrekullueshëm Elenec i cili gjendet në ultësirat e malit të Osogovës me lartësi prej 1300 metra. Në kënaqësi të përgjithshme të të gjithve që erdhën këtë ditë në Elenec, shiu u ndal. Para mysafirëve prezent i pari iu drejtua dhe i përvihendëti Vidan Konevski, kryetari i SHP Makedonska Kamenica. Pastaj mirëseardhje mysafirëve u dëshiroi kryetari i komunës së Komunës së Makedonska Kamenicës dr. Darko Mitevski, ndërsa manifestimin si të hapur e shpalli nënkyetari i KE të LSHPM Saltir Karovski, i cili ishte i mah-



nitur nga numri i mysafirëve përkundër kohës me shi. Para mysafirëve me program kulturo-artistik të parët u prezantuan nikoqirët përmes SHKA "Razigrani penzioneri" nga SHP Makedonska Kamenicë, e cila shfaqi valle, këngë dhe veshje nga rajoni i Vinicës,

ndërsa pas tyre shfaqje kishin edhe më të rinxjtë e SHKA "Janko Gligorov" pranë shtëpisë së kulturës "Koste Misirkov" nga Sveti Nikole, që u shpërblyen me duartrokitje të bujshme nga të pranishmit. Paralelisht me këtë program në vend të hapur rrjedhë edhe gara

"Babina banica". Të gjitë ishin të mirë, por vendin e parë e fituan nikoqirët. Edhe krahas shiut, i tërë programi i planifikuar ishte i realizuar në mënyrë të suksesshme, ndërsa mysafirët morën me vete përshtypje të bukura nga takimi.

## Mbaruan garat sportive rajonale

Më 25 maj në QSR tek ligjeni "Treska2 në Saraj – Shkup kanë garuar sportistët e rajonit të dytë, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 500 pensionistë nga 7 shoqata: Gjorçe Petrov, Tavtalixhe, Karposh, OVR, Tetovë, Gostivar dhe Saraj – shoqata nikoqire



Në organizim të LSHPM gjatë muajit maj dhe qershor janë mbajtur garat rajonale sportive të pensionistëve. Nikoqirët e sukseshtë ishin shoqatat e pensionistëve: SHP Pehçevë, Probištip, Saraj, Veles, Shtip, Ohër dhe Debërc dhe Resnje. Sportistët e rajonit të tretë kanë garuar më 19 maj të vitit 2017 në Qendrën sportive rekreative të ARM në Shkup, ndërsa nikoqir ishte Shoqata e pensionistëve ushtarë. Rreth 300 garues kanë matur forcat dhe kanë treguar se janë mirë të përgatitur fizikisht. Rezultatet më të mira i kanë arritur SHP Gazi Babë, Ilinden dhe Butel. Më 20 maj SHP Pehçevë ishte nikoqir i garave të 22-ta sportive rajonale në të cilën kanë marrë pjesë SHP nga: Koçani, Vinica, Makedonska Kamenica, Dellçeva, Berova dhe Pehçeva. Në këtë rajon në mënyrë ekipo më së shumti vende të para kanë fituar sportistët nga SHP Koçan, në vendin e dytë u gjendën sportistët nga SHP Vinicë, ndërsa në vendin e tretë, pjesëmarrës nga SHP Makedonska Kamenica.

Më 23 maj në Probištip u takuan sportistët e rajonit të gjashtë ku nikoqir ishte shoqata amë e pensionistëve. Rreth 200 pjesëmarrës nga SHP nga Kumanova, Kriva Pallanka, Kratova, Zlletova dhe Probištipi, garuan në 11 disiplina sportive në konkurrencën e meshkujve dhe femrave. Rezultatet më të mira i arritin kumanovarët të cilët fituan 12 vende të para Probištipit dhe Kratovës me nga pesë vende të para. Më 25 maj në QSR tek ligjeni "Treska2 në Saraj – Shkup kanë garuar sportistët e rajonit të dytë, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 500 pensionistë nga 7 shoqata: Gjorçe Petrov, Tavtalixhe, Karposh, OVR, Tetovë, Gostivar dhe Saraj – shoqata nikoqire. Më të mirë ishin pensionistët nga Tetova me 12 vende të para të fituara, para sportistëve nga SHP OVR Shkup me 5 dhe garuesit nga SHP Gjorçe Petrov me 2 vende të para.

Më 31 maj në Veles kanë garuar rreth 350 sportistë – pensionistë nga SHP: Veles, Kavadar, Negotinë, Demir Kapi, Vallandovë, Gjevgjeli, Bogdancë dhe Dojran. Rezultate më të mira kanë arritur nikoqirët nga SHP Veles para sportistëve nga SHP Kavadar dhe SHP Negotinë.

Garat e rajonit të shtatë u mbajtën më 10 qershor të vitit 2017 në Shtip, ku nikoqirët ishin fitues. Të dytë ishin sportistët e SHP Radovish dhe Konçe, ndërsa të tretët ishin pjesëmarrësit nga Strumica. Më 17 qershor 2017 në Ohër u takuan sportistët e rajonit të katërt, ku sérish, sikur me traditë, më të përgatiturit me më së shumti vende të para të fituara ishin garuesit e SHP Ohër dhe Debërc para SHP Strugë dhe SHP Kërçovë. Të gjithë 8 garat sportive rajonale kaluan me frymë të drejtë dhe sportive, ndërsa më të mirët u kualifikuan për pjesëmarrje në Olimpiadën e 22-të jubilare republikane sportive të pensionistëve, e cila për herë të parë do të mbahet në Koçan, qytetin e orizit, më 2 shtator të vitit 2017.